



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Nr. 416 Prot.

Tiranë, më 10.10.2014

SHPLLJA E INTERESIT PËR TRAJNIMIN E PUNONJËSVE ARSIMORË

Bazuar në Udhëzimin nr.26, datë 18.08.2014 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë” dhe “Listës së nevojave të identifikuar për zhvillimin profesional të mësuesve dhe drejtuesve në arsimin parauniversitar për periudhën 2014-2016”, miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit me nr.7227 prot, datë 01.10.2014, njoftohen të gjitha agjencitë trajnuese/universitetet që janë të interesuara për të organizuar trajnime me punonjësit arsimorë, se *fillon periudha e aplikimit për të akredituar programet/modulet e trajnimit* sipas listës së nevojave.

Këto agjenci trajnuese/universitete duhet të paraqesin pranë Institutit të Zhvillimit të Arsimit (IZHA), aplikimet për programe/module trajnimi të cilat kërkohen të akreditoen nga KAT-i.

Dosja e aplikimit duhet të përmbajë këto dokumente:

1. Emri i agjencisë trajnuese;
2. Të dhënat e kontaktit të agjencisë (adresa e postës elektronike, numri i celularit, linku i faqes së internetit të agjencisë, nëse ka);
3. Një kopje e noterizuar e dokumentit juridik të statusit të agjencisë;
4. Tri kopje të formatit të plotëuar të aplikimit për secilin modul (shtojca 2);
5. CV-të e trajnerëve (Shtojca 3);
6. Numri total i krediteve që punonjësit arsimorë kanë fituar në këtë modul nga kjo agjenci.

Agjencitë trajnuese/universitetet të interesuara duhet të paraqesin aplikimet e tyre duke filluar nga data **3 nëntor 2014 – 14 nëntor 2014**. Agjencitë që aplikojnë mbajnë përgjegjësi për plotësimin dhe saktësinë e dokumentacionit të tyre. Për një informacion më të detajuar konsultoni legjislacionin përkatës të publikuar në faqen zyrtare të IZHA-s.

Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet *drejtpërdrejtë pranë sekretariatit të KAT-it, që ndodhet në IZHA deri më datë 14.11.2014*. *Personi i kontaktit: Gentjana Marku (juriste)*, Adresa: Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Rruga: Naim Frashëri nr. 37 , Tiranë, Tel: + 355 4 225 6440, Fax: + 355 4 225 6440, Web site: www.izha.edu.al

DREJTORI

